



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI**

Nr. 608/9 Prot.

Tiranë, më 30/09/2016

V E N D I M

Nr.124, Datë 30/09/2016

PËR

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË KRYER NË ZYRËN VENDORE
TË REGJISTRIMIT TË PASURISË PALUJTSHME DEVOLL "MBI PROCEDURËN
E PRANIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË DOKUMENTACIONIT PËR
REGJISTRIMIN FILLESTAR TË PASURISË TË PALUJTSHME DHE
EVIDENTIMIN E TRAJTIMIN LIGJOR TË MBIVENDOSJEVE"**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, me mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit, në mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "*Mbi procedurën e pranimit dhe Administrimin të dokumentacionit për regjistrimin fillestar të Pasurisë të Paluajtshme dhe evidentimin e trajtimit ligjor të mbivendosjeve*" për periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në 6 raste në ZK 2796 Nikolicë janë konstatuar regjistrime me ndryshime të zërit kadastral në kategoritë nga pyll në pemëtore, në truall , në tokë arë-bujqësore, *në kundërshtim me ligjin nr. 7623, datë 13.10.1992, neni 2,"Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor", ndryshuar me ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 (trajtuar në faqen 17-32 të Raportit Përfundimtar Auditimi).*

Rekomandimi: ZVRPP Devoll, Regjistruesi të kërkojë në organet kompetente plotësimin e dokumentacionit dhe zbatimin e procedurave ligjore për miratimin e ndryshimeve të zërit në 6 raste në ZK 2796 Nikolicë Kadstral në zbatim të *Nr. 7623, datë 13.10.1992, neni 2, ndryshuar me ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005.*

2- Gjetje nga auditimi: Në 1 rast, ZVRPP Devoll ka regjistruar VKKP Korçë nr. 113, datë 22.05.2006 dhe çelur *KPP në v.2, faqe 9 zk.2796* për *pasurinë nr. 1378/2 e llojit Pyll* në pronësi të ish-pronarëve M. M dhe R. L për sipërfaqen **76800 m²** (HTR 155-A) sipas referencës nr. 010, datë 08.09.2014, ndodhur brenda sipërfaqes prej 652 ha, me **parregullsi dhe mungesë dokumentacioni tekniko ligjor**, duke mos përcaktuar kufijtë e ZK 2796 në shtrirje me rrethin e Ersekës, pa përcaktuar kufirin nga organet kompetente ndërmjet 2 rretheve (Devoll-Ersekë), pa përcaktuar statusin juridik të sipërfaqes së pa inventarizuar prej 97Ha, dhe në mungesë të dhënave nga Drejtoritë përkatëse të Shërbimit Pyjor, pa patur hartën 1:25000, të konfirmuara nga DSHP. Është bërë korrigjim harte e karteles pa urdhër të regjistruarit të ZVRPP Devoll. Nuk ka procesverbal dorëzimi të nënshkruar nga përfaqësuesit e Komunës Miras dhe kryeplaku i fshatit Nikolicë. Këto veprime janë në papajtueshmëri me pikën 5 nenin 45, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit”, me pikën 8, Seksioni II, të Udhëzimit Metodik nr. 76, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelave të pasurive të paluajtshme” dhe me pikën 10.6, Kreu i II, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme” (*trajtuar në faqen 17-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi: ZVRPP Devoll, Regjistruesi, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59 të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme të marrë masa për nxjerrjen e urdhrit të kufizimit të pasurisë së regjistruar sipas vendimit nr. 113, datë 22.05.06, çelur *KPP në v.2, faqe 9 zk. 2796* për *pasurinë nr. 1378/2 e llojit Pyll* për sipërfaqen **76800 m²** (HTR 155-A) me referencën nr. 010, datë 08.09.2014, për shkeljet e konstatuara”, deri në përcaktimin dhe plotësimin e dokumentacionit të duhur Ligjor.

31 Dhjetor 2016

3- Gjetje nga auditim: -Në 1 rast është regjistruar vendimi Komisioni të KKP nr. 5, datë 11.06.1997 për pasurinë nr. 776/2, v. 20 f.118 Kullotë .me sipërfaqe 16000 m² me mungesë dokumentacioni si: procesverbalin e marrjes në dorëzim të pronës, Genplan të nënshkruar nga komisioni i pronave dhe pa nënshkrimin e institucionit që e ka në juridiksion,veprim në papajtueshmëri me pikën 9.4, të kreut të IV, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

-Në 1 rast është regjistruar vendimi i Agjencisë Trajtimit të Pronave (ATP) Tiranë nr. 263 ndërsa për një pasuri përcaktuar nr. 779 v.21,f.99 , pjesë e pasurisë nr.1151 me sipërfaqen 11200 m² nuk rezulton të jetë hapur kartelë pasurie, gjendje kjo në kundërshtim me udhëzimin nr. 76, datë 08.05.2003 (*trajtuar në faqen 33-34 të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi*).

Rekomandim: ZVRPP Devoll , Regjistruesi në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme të marrë masa për nxjerrjen e urdhrit të kufizimit” për pasurinë nr. 776/2, v.20 f.118 Kullotë.me sipërfaqe 16000 m² deri në përcaktimin dhe plotësimin e dokumentacionit të duhur Ligjor; si dhe të celë KPP për pasurinë nr. 779 v.21,f.99 , pjesë e pasurisë nr.1151 me sipërfaqen 11200 m² sipas vendimit nr. 263 të ATP Tiranë.

31 Dhjetor 2016

4- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll në 14 raste ka kërkuar pranë KVTP verifikimin e titujve të pronësisë, i cili nga ana e vetë ka kundërshtuar shqyrtimin e verifikimit të titujve me pretendimin për tu shqyrtuar nga Bashkia, duke ju referuar pikës 1/b të Udhëzimit nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të Administratës Publike. ZVRPP Devoll aktet e

kthyerë, të pa shqyrtuara nuk i ka dërguar në Bashkinë e Devollit dhe nuk ka vazhduar procedurat në zbatim të VKM 994, date 9.12.2015 “Për Procedurën e Regjistrimit të AMTP”.

Rekomandimi: ZVRPP Devoll, Regjistruesi të identifikojë pasuritë, të marrë masa kufizuese mbi to dhe të vazhdojë procedurat ligjore të verifikimit në Bashkinë Devoll për pasuritë përcaktuar në 14 kërkesat, e mbetura pa u verifikuar, në zbatim të VKM 994, date 9.12.2015 “Për Procedurën e Regjistrimit të AMTP” (trajtuar në faqen 39-42, të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi).

31 Dhjetor 2016

5- Gjetje nga auditimi: Nga ZVRPP Devoll për disa pasuri në zk. 1202 Bitincë, nuk janë kryer veprimet e shpronësimit dhe të regjistrimit në KPP sipas listës së VKM nr. 64, datë 11.02.1999 për kalimin e pronësisë në favor të Ministrisë Punëve Publike dhe Transportit. Në hartat kadastrale nuk rezulton e hedhur gjurma e rrugës Bilisht-Kapshticë. Janë regjistruar emrat sipas listave të vendimit, ndërsa në vitet pas shpronësimit këto emra janë korrigjuar dhe ndërruar pa u kryer veprimi i shpronësimit. Në të gjitha shpronësimet konstatohet mosveçim i pasurisë shtet dhe në disa raste rezulton të jenë shpronësuar subjekte pa pasur të regjistruara prona sipas KPP.

Nga sa sipër janë përfituar **nga 15 subjekte** në sipërfaqe tepër prej **8505 m² tokë duke mos veçuar, ndarë e regjistruar “shtet” dhe mos bërë bilancin AMTP-LN PIII.**

-Në 15 raste, për një **sipërfaqe 4811 m²**, nuk janë kryer veprime në regjistrat e pasurive të paluajtshme lidhur me shpronësimet dhe kalimin në pronësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, si dhe nuk është hedhur gjurma e rrugës në hartën e punës së ZVRPP.

-Në 4 raste, me sipërfaqe **prej 836 m²**, **me një vlerë prej 668 800 lekë katër** subjekte të evidentuar në listat e shpronësimit, nuk rezulton të kenë të regjistruar e të jenë çelur KPP, pra nuk kanë tituj pronësie për rrjedhojë kanë përfituar në mënyrë të padrejtë shpronësimin, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.

Veprimet e mësipërme janë në papajtueshmëri me nenin 25/a dhe 38 të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të paluajtshme”, ndryshuar me ligjin nr. 33, datë 21.3.2012, me Rregulloren e Brendshme të ZQRPP nr. 184, datë 08.04.1999 dhe me Udhëzimin e ZQRPP nr. 76, datë 08.05.2003 “Për plotësimin e kartelave të Pasurisë së Paluajtshme. (trajtuar në faqen 43-49, të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi).

Rekomandimi: ZVRPP Devoll Regjistruesi të marrë masa të nxjerrë urdhër për të kryer veprimet në regjistrat e pasurive të paluajtshme për **15 raste**, me **sipërfaqe 4811 m²**, dhe për **4 raste**, me sipërfaqe **prej 836 m²**, të përfituar nga shpronësimet si dhe të marrë masa e ti kërkojë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve për të aplikuar regjistrimin e pasurive të mësipërme të shpronësuar. Gjithashtu ZVRPP Devoll të hedhë gjurmën e rrugës në hartën e punës dhe pasqyrojë pasuritë në hartat përkatëse, sipas pasqyrës nr. 6 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar.

31 Dhjetor 2016

6- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll ka regjistruar sipërfaqen prej **131 m² truall në pronësi të D.K i sipas listës së trojeve 001 të fshatit Kapshticë**, pa pasur ndërtim, veprim në kundërshtim me VKM Nr. 432 datë 14.08.1995 dhe VKM nr. 159, datë 21.03.2006, me Dekretin nr. 5747, datë 29.06.1978, i ndryshuar ku përcaktohet: “Për ndërtimin e banesave vetjake në fshatrat fushore jepet një ngastër deri në 200 m² në fshatrat kodrinore e malore deri në 300 m² dhe në qytete, sipas rastit, 140 deri 170 m²” dhe me nenin 24/a të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994, pasqyruar në Pasqyrën nr. 4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar.

Rekomandimi: ZVRPP Devoll, Regjistruesi, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të marrë masa për nxjerrjen e urdhrit të Kufizimit për pasurinë nr. 203/202 në emër të **D.K** deri

në përcaktimin dhe plotësimin e dokumentacionit si dhe në të ardhmen të mos kryhen regjistrime trojesh edhe me lista 0001 edhe me AMTP në zbatim të VKM nr. 159, datë 21.03.1996 dhe dekretit nr. 5747, datë 29.06.1978 (trajtuar në faqen 111-115, të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi).

31 Dhjetor 2016

7- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll ka regjistruar sipërfaqen prej **410 m² truall në pronësi të A.B, sipas listës së trojeve 001 të fshatit Cangonj** listë pa nënshkrimin e Kryetarit të Komunës dhe Kryeplakut, pa pasur ndërtim, veprim në kundërshtim me *VKM Nr. 432 datë 14.08.1995 dhe VKM nr. 159, datë 21.03.2006*, me Dekretin nr. 5747, datë 29.06.1978, i ndryshuar ku përcaktohet: *“Për ndërtimin e banesave vetjake në fshatrat fushore jepet një ngastër deri në 200 m² në fshatrat kodrinore e malore deri në 300 m² dhe në qytete, sipas rastiit, 140 deri 170 m²”* dhe me nenin 24/a të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994, pasqyruar në Pasqyrën nr. 5, bashkëlidhur (trajtuar në faqen 111-115, të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi)

Rekomandimi: ZVRPP Devoll, Regjistruesi, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të marrë masa për nxjerrjen e urdhrimit të Kufizimit për pasurinë nr. 203/202 në emër të **A.B**, deri në përcaktimin dhe plotësimin e dokumentacionit si dhe në të ardhmen të mos kryhen regjistrime trojesh edhe me lista 0001 edhe me AMTP në zbatim të VKM nr. 159, datë 21.03.1996 dhe dekretit nr. 5747, datë 29.06.1978, i ndryshuar, pasqyruar ne Pasqyrën nr. 5, bashkëlidhur (trajtuar në faqen 111-115, të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi).

31 Dhjetor 2016

8- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll nuk ka një rregullore të funksionit të zyrës, nuk ka procesverbale të dorëzimit të detyrë nga ish-regjistruesit në lidhje me dorëzimin e praktikave në proces e praktikave të tjera. Nuk janë evidentuar, raportuar e nuk janë zbatuar procedurat ligjore për pasuritë e regjistruara dhe konstatuara me mbivendosjet nuk janë njoftuar palët, dhe nuk është rekomanduar ndjekja në rrugë gjyqësore për to, në kundërshtim me ligjin nr. 33, datë 21.3.2012 dhe me rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999 (trajtuar në faqen 143-146, të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi).

Rekomandimi: ZVRPP Devoll, Regjistruesi të marrë masa të hartojë miratojë e zbatojë rregulloren e funksionimit të zyrës, të dokumentojnë e hartojnë procesverbalet përkatëse marrjes dhe të dorëzimit të detyrës nga ish-regjistruesit dhe personeli në lidhje me dorëzimin e praktikave në proces e praktikave të tjera. Të identifikojë evidentojë, raportojë gjendjen e praktikave në proces, të zbatojë procedurat ligjore për pasuritë e regjistruara dhe konstatuara me mbivendosje sidomos mbivendosjet në Fshatin Nikolicë; si dhe të njoftojë palët, duke ju rekomanduar ndjekjen në rrugë gjyqësore .

31 Dhjetor 2016

9- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll në **10 raste** në ZK 3804 Fshati Bilisht ka regjistruar në kartelat e pasurive të paluajtshme dhe ka lëshuar certifikata pronësie, për pasuri sipas AMTP-ve, **të cilat nuk janë nënshkruar nga Kryetari i Komisionit të ndarjes së tokës në fshat**, si dhe në **7 raste** AMTP pasurive u **mungojnë përcaktimet e kufijve** të parcelave. Nga ZVRPP Devoll nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes së Aktit Administrativ të llojit AMTP, veprime këto në **papajtueshmëri me** shkronja “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me shkronjën “b” pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” dhe me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e

elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” dhe shkronja “a” pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individ a institucione” (*trajtuar në faqen 49-92 të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi*).

Rekomandim: ZVRPP Devoll, Regjistruesi të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e ZK 3804 Bilisht, duke përjashtuar nga kufizimi pasuritë që preken nga gjurma e Projektit TAP, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015, pasqyruar në tabelën nr. 1 (bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit),

31 Dhjetor 2016

10- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll në ZK 3804 Fshati Bilisht ka regjistruar më tepër në **26 raste sipërfaqen prej + 63350 m² tokë bujqësore** që u përkasin **40 parcelave**, pa bërë bilancin AMTP-LN PIII, pa veçuar e regjistruar “shtet” sipërfaqet e tepërta, pasuri të cilat janë refuzuar më parë për tu marrë në pronësi, dhe ka lëshuar certifikata pronësie; veprime në **papajtueshmëri me** shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me germën b/iv, pika 2.2 UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”, me germën ç, pika I, të UKM Nr. 2, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individ a institucione” (*trajtuar në faqen 49-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: ZVRPP Devoll, Regjistruesi në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” të marrë masa, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë në **26 raste sipërfaqen tepër prej + 63350 m² tokë bujqësore** ZK 3804 Bilisht, duke përjashtuar nga kufizimi pasuritë që preken nga gjurma e Projektit TAP, si dhe të bëjë bilancin AMTP-LN PIII, dhe të veçojë e regjistrojë “shtet” sipërfaqet e tepërta deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015, pasqyruar në tabelën nr. 1 (bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit),

31 Dhjetor 2016

11- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll në **1 rast**, ka regjistruar në kartelat e pasurive të paluajtshme 8 pasuri me sipërfaqe totale prej **13340 m²** dhe ka lëshuar certifikata pronësie, për disa nga këto pasuri që i përkasin ZK 3804 Fshati Bilisht, regjistruar sipas AMTP nr. 5, e cila është pa datë dhe **nuk është origjinale**, por **fotokopje e pa noterizuar dhe e pa konfirmuar nga pushteti lokal, ndërsa në ZVRPP Devoll nuk ndodhet AMTP origjinale**, veprim në papajtueshmëri me shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me germën dh, pika 1 të UKM Nr. 2, datë 13.06.2013 “Për Mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike për pasuritë e paluajtshme të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” dhe me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” (*trajtuar në faqen 49-92, të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi*).

Rekomandim: ZVRPP Devoll, Regjistruesi në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” të marrë masa, të nxjerrë urdhër kufizimi për 8 pasuri me sipërfaqe totale prej **13340 m²** ZK 3804 Bilisht, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015, pasqyruar në tabelën nr. 1 (bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit),

31 Dhjetor 2016

12- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll në **1 rast**, ka regjistruar në kartelat e pasurive të paluajtshme 8 pasuri me sipërfaqe totale prej **24626 m²** dhe ka lëshuar certifikata pronësie, sipas AMTP nr. 123, pa datë, ZK 3644, Fshati Trestenik, ***e cila nuk është nënshkruar nga Kryetari i Komisionit të ndarjes së tokës në fshat***, ndërsa nga ZVRPP Devoll nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes së Aktit Administrativ, veprime këto në ***papajtueshmëri me*** shkronja “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me shkronjën “b” pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” dhe shkronja “a” pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individ a institucione” (*trajtuar në faqen 92-105, të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi*).

Rekomandim: ZVRPP Devoll, Regjistruesi të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë regjistruar sipas AMTP nr. 123, pa datë, ZK 3644, Fshati Trestenik, duke përjashtuar nga kufizimi pasuritë që preken nga gjurma e Projektit TAP, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015, pasqyruar në tabelën nr. 2 (bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit),

31 Dhjetor 2016

13- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll në **1 rast**, ka regjistruar në kartelat e pasurive të paluajtshme 10 pasuri me sipërfaqe totale prej **31374 m²** dhe ka lëshuar certifikata pronësie për dy nga këto pasuri, regjistruar sipas AMTP nr. 29, pa datë, ZK 3644, Fshati Trestenik, ***e cila rezulton e korrigjuar, duke shtuar një parcelë, regjistruar në KPP, pasuria nr. 1148/1, vol. 1, faqe 190, e llojit pemëtoze me sipërfaqe 920 m²***, ndërsa nga ZVRPP Devoll nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes së Aktit Administrativ, veprime këto në ***papajtueshmëri me*** shkronja “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me germën b/iv, pika 2.2, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” (*trajtuar në faqen 105-111, të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi*).

Rekomandim: ZVRPP Devoll, Regjistruesi në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” të marrë masa, të nxjerrë urdhër kufizimi për 10 pasuri me sipërfaqe totale prej **31374 m²** regjistruar sipas AMTP nr. 29, pa datë, ZK 3644, Fshati Trestenik, duke përjashtuar nga kufizimi pasuritë që preken nga gjurma e Projektit TAP, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015, pasqyruar në tabelën nr. 2 (bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit),

31 Dhjetor 2016

14- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll në **8 raste**, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme në pronësi të poseduesve të AMTP-ve, të ndodhura në ZK 3644, Fshati Trestenik, duke regjistruar **më tepër 18600 m² sipërfaqe tokë bujqësore**, që i përket diferencës ndërmjet sipërfaqeve faktike të përcaktuar sipas LN gusht 1996 me sipërfaqen e parcelave të përcaktuar në AMTP dhe që janë regjistruar në KPP, ndërsa ZVRPP Devoll ka kryer shërbime për poseduesit, duke lëshuar certifikata pronësie për disa nga këto pasuri, si dhe **nuk janë marrë masa për të kthyer në pronësi të shtetit** këtë sipërfaqe të tepërt, veprim në **papajtueshmëri me** shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me germën b/iv, pika 2.2 UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”, me germën ç, pika I, të UKM Nr. 2, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individ a institucione” (trajtuar në faqen 92-105, të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi).

Rekomandim: ZVRPP Devoll, Regjistruesi në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” të marrë masa, të nxjerrë urdhër kufizimi në **8 raste**, për pasuritë me **sipërfaqen e tepërt prej 18600 m² tokë bujqësore**, ZK 3804 Bilisht, duke përjashtuar nga kufizimi pasuritë që preken nga gjurma e Projektit TAP, si dhe të bëjë bilancin AMTP-LN PIII, dhe të veçojë e regjistrojë “shtet” sipërfaqet e tepërta, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015, pasqyruar në tabelën nr. 2(bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit),

31 Dhjetor 2016

15- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll në **5 raste**, ka regjistruar pasuritë: nr. 1285/1, arë me sipërfaqe 8076 m², ZK 3644; nr. 1331/11, arë me sipërfaqe 3250 m², ZK 3644; nr. 368/14, arë me sipërfaqe 1962 m², ZK 1955; nr. 1408/6, arë me sipërfaqe 3400 m²; ZK 1955; nr. 12/40, arë me sipërfaqe 532 m², ZK 1355, duke lëshuar certifikata pronësie, rezulton se regjistrimi i këtyre pasurive, duke tjetërsuar pronësinë **nga shteti tek privati, për sipërfaqen në total prej 17220 m², është bërë pa asnjë akt administrativ, që përbën Titull Pronësie, apo vendim gjykate të formës së prerë**, veprim në papajtueshmëri me shkronjën “a” neni 25, me pikën 5 nenin 45, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrat të regjistruesit” (trajtuar në faqen 105-111, të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Devoll të marrë masa, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 368/14, volumni 12, faqe 8, ZK 1955; nr. 1408/6, volumni 15, faqe 175, ZK 1955; nr. 12/40, volumni 10, faqe 187, ZK 1355, si dhe të veçojë e regjistrojë “shtet” sipërfaqen **totale prej 17220 m²**, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

31 Dhjetor 2016

16- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll në **1 rast**, ka regjistruar në kartelat e pasurive të paluajtshme, pa titull ligjor pronësie pasurinë nr. 1385/2, e llojit arë+zallishte, me sipërfaqe **19575 m²**, mbi të cilën janë kryer transaksione dhe është lëshuar certifikatë pronësie me datë 04.02.2015, ku rezulton se regjistrimi i pasurisë nr. **1385**, e llojit **zallishte me sipërfaqe 14266 m²**, si përbërëse e pasurisë nr. 1385/2, e llojit arë+zallishte, **është bërë në mungesë të aktit administrativ apo vendim gjykate të formës së prerë, që shërben për të fituar**

Titullin e Pronësisë, veprim në papajtueshmëri me shkronja “a” neni 25, të ligjit nr. 7843, datë 1.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, me shkronjat “d” dhe “e” neni 20, me pikën 5 neni 45, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrin të regjistruarit” (*trajtuar në faqen 129-134, të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Devoll të marrë masa, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 1385/2, vol. 15, faqe 113, ZK 3804, me sipërfaqe **19575 m²**, e llojit “arë+zallishte” deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe zgjidhjen nga organet kompetente.

31 Dhjetor 2016

17- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll në **1 rast**, ka regjistruar e lëshuar certifikatë për pasuritë, nr. 4/46N3, volum 19, faqe 145, nr. 4/46+1-1, volum 19, faqe 146, nr. 4/46+1-6, volum 19, faqe 151, nr. 4/46+1-8, volum 19, faqe 153, nr. 4/46+1-10, volumin 19, faqe 155, nr. 4/46+1-14, volum 19, faqe 159, nr. 4/46+1-15, volum 19, faqe 160, nr. 4/46+1-16, volum 19, faqe 161, nr. 4/46+1-19, volum 19, faqe 164, ZK 1187 pasi *vendimi i KRRT-së nr. 15 datë 26.10.2010 i referohet sheshit të ndërtimit nr. 15 datë 26.10.2010 formulari nr. 2 i cili nuk ndodhet në dosje, gjithashtu leja e përdorimit është pa numër protokoll.* Në *dosje mungojnë:* Dokumenti i pronësisë marrëdhëniet me truallin, studimi Urbanistik pjesor i miratuar nga KRRT, prerjet dhe pamjet strukturore të objektit, projekti elektrik, i ngrohjes, projekti hidraulik dhe i mbrojtjes nga zjarri. Këto veprime janë në papajtueshmëri me nenin 38 paragrafi 2 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” i ndryshuar, pikat c dhe e të nenit 20, pikën 1 neni 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 me nenin 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998, të ndryshuar, me ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 , i ndryshuar, nenin 79 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009, i ndryshuar, me pikën 1 të Urdhrit nr. 6 datë 21.01.2001 të Kryeregjistruarit, dhe pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 (*trajtuar në faqen 115-129, të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Devoll të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 4/46N3, volum 19, faqe 145, nr. 4/46+1-1, volum 19, faqe 146, nr. 4/46+1-6, volum 19, faqe 151, nr. 4/46+1-8, volum 19, faqe 153, nr. 4/46+1-10, volumin 19, faqe 155, nr. 4/46+1-14, volum 19, faqe 159, nr. 4/46+1-15, volum 19, faqe 160, nr. 4/46+1-16, volum 19, faqe 161, nr. 4/46+1-19, volum 19, faqe 164, ZK 1187 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

31 Dhjetor 2016

18- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll në **1 rast**, ka regjistruar e lëshuar certifikatë, për pasurinë nr. 6/744, volum 20, faqe 5, ZK 1187, por në *dosje mungojnë formulari nr. 2, studimi urbanistik/ pjesor i miratuar nga KRRT, projekti i dorëzuar është i pa plotë, në mungesë të prerjeve dhe pamjeve strukturore të objektit, elektrike, ngrohjes, hidraulike, mbrojtjes nga zjarri.* Këto veprime janë në papajtueshmëri me nenin 38 paragrafi 2 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, i ndryshuar, nenin 38 paragrafi 2 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 i ndryshuar, pikën 1 neni 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, me nenin 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998 i ndryshuar, pikën 1 të Urdhrit nr. 6 datë 21.01.2001 të Kryeregjistruarit dhe pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 (*trajtuar në faqen 115-129, të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Devoll të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 6/744, volum 20, faqe 5, ZK 1187 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

31 Dhjetor 2016

19- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll në **1 rast**, ka regjistruar ka regjistruar e lëshuar certifikatë për pasuritë nr. 6/210 N1, volum 16, faqe 211, nr. 6/210 N2, volum 16, faqe 212, nr. 6/210 N3, volum 16, faqe 213, nr. 6/210 +1-1, volum 16, faqe 214, nr. 6/210 +2-1, volumin 16, faqe 215, nr. 6/210 +1-4, volum 16, faqe 218, nr. 6/210 +1-5, volum 16, faqe 219, ZK 1187 pasi *vendimi i KRRT nr. 10 datë 03.07.2007 i referohet sheshit të ndërtimit nr. 11 datë 28.06.2004 të cilit i ka përfunduar afati prej 6 muajsh, në dosje mungojnë: Studimi Urbanistik pjesor i miratuar nga KRRT, projekti i dorëzuar është i pa plotë, në mungesë të prerjeve dhe pamjeve strukturore të objektit, elektrike, ngrohjes, hidraulike, mbrojtjes nga zjarri.* Veprime këto në papajtueshmëri me nenin 38 paragrafi 2 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, i ndryshuar, pikat c dhe e të nenit 20 pikën 1 neni 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, me nenin 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998, të ndryshuar, ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998, i ndryshuar nenin 79 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009, të ndryshuar, pikën 1 të Urdhrit nr. 6 datë 21.01.2001 të Kryeregjistruesit dhe pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 (*trajtuar në faqet 115-129, të Raportit Përfundimtar Auditimi*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Devoll të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 6/210 N1, volum 16, faqe 211, nr. 6/210 N2, volum 16, faqe 212, nr. 6/210 N3, volum 16, faqe 213, nr. 6/210 +1-1, volum 16, faqe 214, nr. 6/210 +2-1, volumin 16, faqe 215, nr. 6/210 +1-4, volum 16, faqe 218, nr. 6/210 +1-5, volum 16, faqe 219, ZK 1187 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

31 Dhjetor 2016

20- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll në **1 rast**, ka regjistruar e lëshuar certifikatë për pasuritë nr. 5/476N2, volum 16, faqe 6, nr. 5/476N4, volum 16, faqe 8, ZK 1187, pasi *me vendim të KRRT nr. 10 datë 14.08.2006 është miratuar leja e ndërtimit e cila i referohet sheshit të ndërtimit. nr. 10 datë 14.08.2006 i cili nuk ndodhet në dosje. Në dosje mungojnë gjithashtu: Studimi Urbanistik pjesor i miratuar nga KRRT. Akti i kolaudimit për shtesën, Projekti i dorëzuar është i pa plotë, në mungesë të prerjeve dhe pamjeve strukturore të objektit, elektrike, ngrohjes, hidraulike, mbrojtjes nga zjarri.* Veprime këto në papajtueshmëri me nenin 38 paragrafi 2 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, i ndryshuar, pikat c dhe e të nenit 20, pikën 1 neni 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 me nenin 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998, të ndryshuar, ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998, i ndryshuar nenin 79 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009, të ndryshuar, pikën 1 të Urdhrit nr. 6 datë 21.01.2001 të Kryeregjistruesit dhe me pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 (*trajtuar në faqen 115-129, të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Devoll të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 5/476N2, volum 16, faqe 6, nr. 5/476 N4, volum 16, faqe 8, ZK 1187 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

31 Dhjetor 2016

21- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll në **1 rast**, ka regjistruar e lëshuar certifikatë për pasurinë nr. 1/66, volum 6, faqe 3, ZK 1187, pasi në dosje mungon *Kontrata e marrëdhënieve me truallin pas vitit 1991, për shitjen e truallit midis Këshillit të Rrethit dhe blerësit*. Ky veprim është në pajtueshmëri me nenin 38 paragrafi 2 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, i ndryshuar nenin 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998 të ndryshuar, me pikën 12.3, 12.5 të kreut të IV, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 të ndryshuar, me ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998, i ndryshuar, me pikat c dhe e të nenit 20 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, me pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 (*trajtuar në faqet 115-129, të Raporti Përfundimtar Auditimi*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Devoll të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 1/66, volum 6, faqe 3, ZK 1187 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

31 Dhjetor 2016

22- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll, ka regjistruar e lëshuar certifikata për pasurinë (nr. 20-41 sipas tabelës nr. 7) në kushtet kur në këtë (KPP) **nuk është bërë hedhja e ndërtesës, nuk është plotësuar seksioni B i kartelës si dhe pika 2, kuota e pjesëmarrjes dhe numri i pasurisë pallat**. Gjithashtu **objekti nuk është përfunduar në fasadën e jashtme, ballkonet janë të papërfunduar me parmakët dhe muret mbajtëse, nuk janë vendosur dyer dhe dritaret, si dhe nuk është bërë lyerja e pallatit**. **Në dosje mungojnë:** *Studimi Urbanistik pjesor i miratuar nga KRRT. Projekti i dorëzuar është i paplotë, në mungesë të prerjeve dhe pamjeve strukturore të objektit, elektrike, ngrohjes, hidraulike, mbrojtjes nga zjarri*. Veprime këto në pajtueshmëri me pikën 5.1, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999, me nenin 38 paragrafi 2 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, i ndryshuar, pikat c dhe e të nenit 20, pikën 1 neni 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, me nenin 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998, të ndryshuar, ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998, i ndryshuar, nenin 79 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 i ndryshuar, pikën 1 të Urdhrit nr. 6 datë 21.01.2001 të Kryeregjistruesit dhe me pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 (*trajtuar në faqet 115-129 të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Devoll të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr.20-41 ZK 1187, sipas pasqyrës nr. 7, bashkëlidhur në Raportin Përfundimtar Auditimit, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

31 Dhjetor 2016

23- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll në **1 rast**, ka regjistruar e lëshuar certifikatë për pasurinë nr. 2/200, volum 3, faqe 243, ZK 1187, por në dosje **mungojnë: Kontrata e shitjes së truallit midis Këshillit të Rrethit/ Bashkisë dhe blerësit, duke regjistruar vetëm ndërtesa dhe transaksioni është kryer vetëm për ndërtesën për të mundësuar blerjen e truallit, sipas shënimeve në seksionin (Përshkrimi i veçantë) të kartelës**. Veprime këto në pajtueshmëri me nenin 38 paragrafi 2 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, i ndryshuar, nenin 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998, të ndryshuar, me pikën 12.4, të kreut të IV, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999, të ndryshuar, ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998, i ndryshuar, me pikat c dhe e të nenit 20 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, me pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 (*trajtuar në faqen 115-129 të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Devoll të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të

Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 2/200, volum 3, faqe 243, ZK 1187, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

31 Dhjetor 2016

24- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll në **1 rast** ka regjistruar e lëshuar certifikatë për pasurinë nr. 2/239, volum 17, faqe 152, ZK 1187, por në dosjen e lejes së ndërtimit miratuar me Vendimin nr. 21, datë 18.04.1994 ***mungon: leja e sheshit të ndërtimit, e miratuar nga KRRT.*** Veprime këto në papajtueshmëri me nenin 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998 i ndryshuar, me pikën 12.1, të kreut të IV, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 i ndryshuar. nenin 38 paragrafi 2 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 i ndryshuar, me pikat c dhe e të nenit 20 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, me pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012, me pikën 6 të Udhëzimit nr. 1 datë 31.01.2007, i ndryshuar (*trajtuar në faqen 115-129, të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Devoll të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 2/239, volum 17, faqe 152, ZK 1187, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

31 Dhjetor 2016

25- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll në **1 rast** ka regjistruar e lëshuar certifikatë për pasurinë nr. 5/377, volum 12, faqe 36, ZK 1187, por në dosjen e lejes së ndërtimit miratuar me vendim të KRRT nr. 3 datë 30.05.2003 ***mungojnë: Studimi Urbanistik/ pjesor i miratuar nga KRRT. Projektin dhe kushtet urbanistike të miratuara për sheshin e ndërtimit, plani i vendosjes së objektit, gjithashtu në shkresën përcjellëse me nr. extra prot, datë 13.04.2004 të Bashkisë Bilisht, nuk është lista e dokumenteve që përcillen si dhe dokumentacioni tekniko ligjor që mundësojnë regjistrimin e objektit, nuk ka vulën lidhëse në çdo faqe që bën të mundur autenticitetin e dokumentacionit.*** Këto veprime janë në papajtueshmëri me nenin 38 paragrafi 2 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, i ndryshuar, pikat c dhe e të nenit 20 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, me nenin 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998 i ndryshuar, ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998, i ndryshuar, pikën 1 të Urdhrit nr. 6 datë 21.01.2001 të Kryeregjistruesit, me pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 (*trajtuar në faqe 115-129, të Raporti Përfundimtar Auditimi*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Devoll të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 5/377, volum 12, faqe 36, ZK 1187, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajit Nëntor 2016

26- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll në **1 rast**, ka regjistruar e lëshuar certifikatë për pasurinë nr. 6/800, volum 20, faqe 201, ZK 1187, por në vendimin e KRRT-së nr. 21 datë 23.09.2004 sipërfaqja e sheshit të ndërtimit është 730 m², ndërsa në KPP volum 20, faqe 201 është regjistruar 527.3 m², ***pra më e vogël se formulari nr. 2 me një diferencë prej 202.7 m².*** ***Në dosje mungojnë:*** Dokumenti i pronësisë marrëdhëniet me truallin, ku personi juridik ndërtues duhet të paraqesë kontratën e lidhur me pronarin e tokës ose me personin që ka marrë sheshin e ndërtimit nga KRRT-ja”. Projekti i dorëzuar është i pa plotë, në mungesë të prerjeve dhe pamjeve strukturore të objektit, elektrike, ngrohjes, hidraulike, mbrojtjes nga zjarri. Këto veprime janë në papajtueshmëri me nenin 38 paragrafi 2 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 i ndryshuar, pikat c dhe e të nenit 20 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, me nenin 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998 i ndryshuar, ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 dhe me pikën 2

paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 (*trajtuar në faqet 115-129, të këtij Raporti Përfundimtar i Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Devoll të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 6/800, volum 20, faqe 201, ZK 1187, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

31 Dhjetor 2016

27- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll në **1 rast**, ka regjistruar e lëshuar certifikatë për pasuritë nr. 3/256 N2, volum 17, faqe 4 dhe pasuria nr. 3/256 N3, volum 17, faqe 5, ZK 1187, por sipërfaqja e sheshit të ndërtimit miratuar me **vendimin e KRRT nr. 6 datë 04.07.2006 është 295 m², ndërsa në KPP volum 15, faqe 22 është regjistruar 300 m², pra më e madhe se formulari nr. 2 me një diferencë prej 5 m² më shumë, në planimetritë e kateve nuk paraqitet sipërfaqja totale e ndërtimit. Në dosje mungojnë:** Studimi urbanistik, projekti i dorëzuar është i pa plotë, në mungesë të prerjeve dhe pamjeve strukturore të objektit, elektrike, ngrohjes, hidraulike, mbrojtjes nga zjarri. Këto veprime janë në papajtueshmëri me nenin 38 paragrafi 2 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, i ndryshuar, pikat c dhe e të nenit 20 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, me nenin 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998 i ndryshuar, ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998, i ndryshuar, me pikën 1 të Urdhrit nr. 6 datë 21.01.2001 të Kryeregjistruesit dhe me pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 (*trajtuar në faqet 115-129, të këtij Raporti Përfundimtar i Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Devoll të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 3/256 N2, volum 17, faqe 4 dhe pasuria nr. 3/256 N3, volum 17, faqe 5, ZK 1187, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

31 Dhjetor 2016

28- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll në **1 rast**, ka regjistruar e lëshuar certifikatë për pasurinë nr. 2/311, volum 15, faqe 146, ZK 1187 por në vendimin e Komisionit të Regjistrimit nr. 136 dt, 09.05.2006 **nuk është pasqyruar sipërfaqja e ndërtesës ndërsa në (KPP) volum 15, faqe 146, është regjistruar edhe ndërtesa me sipërfaqe 80 m².** Në kërkesën për regjistrim pronësie datë 05.05.2006, **pika B nuk është paraqitur sipërfaqja e ndërtesës, si dhe në deklaratën personale të kërkuarit mungon nënshkrimi i kërkuarit.** Dokumenti mbështetës i paraqitur është Leja e Ndërtimit e Këshillit Popullor Bilisht me nr. ext prot datë 16.11.1979 akt i cili **nuk përmban vulën e institucionit që e ka lëshuar. Deklarata noteriale pronarëve kufitarë, në dy pjesë është vendosur Bashkia Bilisht e cila nuk i ka të regjistruara në pronësi të saj këto dy pasuri si e tillë nuk mund të shprehet në cilësinë e pronarit kufitar.**

- Gjithashtu në relacionin e Komisionit të Regjistrimit nr. 136 dt, 09.05.2006 në pikën 1. “Ana teknike”, shprehet se pasuria është e azhurnuar në HTR BI- G- 5, ndërsa në KPP volum 15, faqe 146, kjo pasuri mban indeksin e hartës BI- G- 4, pra ka një mospërputhje dhe zhvendosje të pasurisë. Këto veprime janë në papajtueshmëri me kreun IV, me germën “a” neni 24 të l i g j nr. 7843, datë 13.7.1994 i ndryshuar me pikat c dhe e të nenit 20 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, me pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012, **me nenin 16 paragrafi 3 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 i ndryshuar me pikat c dhe e të nenit 20 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, me pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 (trajtuar në faqet 115-129, të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi).**

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Devoll të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të

Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 2/311, volum 15, faqe 146, ZK 1187, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

31 Dhjetor 2016

29- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll në **1 rast**, ka regjistruar e lëshuar certifikatë për pasurinë nr. 2/170, volum 6, faqe 135, ZK 1187, por në bazë të nenit 24/b dokumenti mbështetës i paraqitur është **Vërtetimi gjyqësor i faktit të pronësisë** nr. 696 akti, datë 07.06.1996, dokument i cili nuk përmbush kushtet në kuptim të nenit 24/a. Këto veprime janë në papajtueshmëri me kreun IV, germën “a” neni 24 të l i g j nr. 7843, datë 13.7.1994 “, i ndryshuar me pikat c dhe e të nenit 20 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, me pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012. (*Trajtuar në faqet 140-142 të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Devoll të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 2/170, volum 6, faqe 135, ZK 1187, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

31 Dhjetor 2016

30- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll në **1 rast**, ka regjistruar e ka lëshuar certifikatë për pasurinë nr. 5/156, volum 3, faqe 18, ZK 1187, pasi **Vendimi i Gjykatës së Rrethit Devoll nr. 527, datë 11.10.1995, përmban faktin e pronësisë**, kur me daljen e Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për kodin civil të Republikës së Shqipërisë”, neni 193 germa h, paragrafi i fundit, parashikon se: Vërtetimet gjyqësore të faktit të pronësisë nuk regjistrohen, gjithashtu nuk janë bërë verifikimet e elementeve dhe të dhënave të aktit, i cili është regjistruar më parë në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Këto veprime janë në papajtueshmëri me nenin 24, pika “a” të Ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 i ndryshuar me pikat c dhe e të nenit 20, nenin 25 germa “a” të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 dhe me pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 (*trajtuar në faqet 137-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Devoll të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 5/156, volum 3, faqe 18, ZK 1187, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

31 Dhjetor 2016

31- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Devoll në **1 rast**, ka regjistruar e lëshuar certifikatë për pasurinë nr. 5/156+1-3, volum 16, faqe 124, ZK 1187, por në dosjen e lejes së ndërtimit miratuar me vendimin e KRRT-së nr. 11, datë 14.08.2006, **mungojnë: Certifikata e pronësisë e tre muajve të fundit për marrëdhëniet me truallin**, ku personi juridik ndërtues duhet të paraqesë kontratën e lidhur me pronarin e tokës ose me personin që ka marrë sheshin e ndërtimit nga KRRT-ja”. Studimi Urbanistik pjesor i miratuar nga KRRT. Projekti i prerjeve dhe pamjeve strukturore të objektit, elektrike, ngrohjes, hidraulike, mbrojtjes nga zjarri etj. Këto veprime janë në papajtueshmëri me nenin 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998 i ndryshuar, me pikën 12.2 dhe 12.4, të kreut të IV, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 të ndryshuar, me pikat c dhe e të nenit 20 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, me pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 (*trajtuar në faqet 115-129, të Raportit Përfundimtar Auditimi*).

